



Prishtinë, 11 nëntor 2010

Kodi i ZRRE-së: V_296_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 15 paragrafi 2 pika (d) dhe nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9 të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 4 dhe 12 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Gjeneruese, rrjetave të gasit, linjave direkte elektroenergjetike dhe linjave gypore direkte;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 23.1MW që përbëhet prej tri njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: “Lumëbardhi II” me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, “Belaja” me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, të gjitha në komunën e Deçanit, të datës 09.08.2010 të ndërmarrjes Kelkos - Energy sh.p.k., me adresë “Arbëria” Dragodani – Zagrebit 19 – Top 22 Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Kelkos – Energy” sh.p.k. ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) nga uji, me kapacitet të tërësishëm të instaluar prej 23.1 MW, që përbëhet prej tri njësive gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: “Lumëbardhi II” me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, “Belaja” me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, të gjitha në komunën e Deçanit.
- II. Aplikantit Kelkos –Energy sh.p.k. mund t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenin 12 dhe 13 të Rregullit mbi Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues.
- III. Ky Njoftim nuk nënkupton edhe lëshimin e Autorizimit përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.

Arsyetim

ZRRE me datë 09.08.2010 nga ndërmarrja **Kelkos – Energy sh.p.k.**, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga uji, me kapacitet të instaluar prej 23.1 MW, që përbëhet prej tri njësie gjeneruese që do të vendosen në lokacionet: “Lumëbardhi II” me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, “Belaja” me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW, dhe “Deçan” me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, të gjitha në komunën e Deçanit.

ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura dhe pranimit të dëshmive plotësuese të kërkuara, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda (14) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRrE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar.